



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 13 25 - 31 Mars 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 13

	JAVA 13
DIARRE PA GJAK	1.058
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	8.351
INF. RESP. TE POSHTËME	4.184
RASH ME TEMPERATURË	23
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	424
% e Njësive Raportuese	96% (424/441)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Fier – 2 raste

Pogradec – 1 rast


Tiranë – 20 raste

Diarre me gjak


Rasti i grupmoshës 5-14 vjeç është raportuar nga NJVKSH Vlorë dhe është në hetim.

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet e qëndrueshme në javën 13 krahasuar me javën paraardhëse, java 12.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqitet e qëndrueshme në javën 13 krahasuar me javën paraardhëse, java 12.

Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 05 – 12 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.




Në javën 13 të vitit 2024 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 12 dhe 13 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




**Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 05 - 12 të viteve 2023 dhe 2024.
Numri i rasteve.**



Në javën 13 të vitit 2024 vërehet e qëndrueshme në rënie e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 12 dhe 13 / 2024.
Incidenca (raste/10.000)**



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje ndërkombëtare

1. Kolera –Monitorimi i shpërthimeve globale

- Në shkurt 2024, janë raportuar 27 184 raste të reja të kolerës, duke përfshirë 248 vdekje të reja në mbarë botën.
- Raste të reja janë raportuar nga Afganistani, Burundi, Kameruni, Komoret, Republika Demokratike e Kongos, Etiopia, Kenia, Malavi, Mozambiku, Nigeria, Pakistani, Somalia, Afrika e Jugut, Uganda, Republika e Bashkuar e Tanzanisë, Zambia dhe Zimbabve.
- Në muajt e fundit, rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikën perëndimore, lindore dhe jugore, disa pjesë të Lindjes së Mesme, Azisë dhe Amerikës. Rreziku i infeksionit nga kolera tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse importimi sporadik i rasteve në BE/ZEE mbetet i mundshëm.